

Homeri – Iliada

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Tiparet e përgjithshme të epikës të pasqyruara tek “Iliada”.

Fillesa mitologjike e “Iliadës”.

Çfarë marrëdhëniesh kanë njerëzit me perënditë në “Iliadë”? Ç’përfundim nxirrnin nga kjo për natyrën e njerëzve dhe perëndive?

-shënime-

Cila është koha e rrëfimit në “Iliadë”?

Cila është hapësira e rrëfimit (vendi i zhvillimit të ngjarjeve) në “Iliadë”?

Përcaktoni konfliktin e poemës.

Analizoni çiftet e personazheve në poemë dhe mesazhet që përcillen prej tyre.

Akili dhe Hektori – Kulti i heroizmit

Paridi dhe Helena – Kulti i dashurisë

Hektori dhe Andromaka – Kulti i familjes

Agamemnoni dhe Priami – Kulti i sundimitarit

Personazhet e “Iliadës” janë heronjtë tipikë të kohës homerike. Heroizmi i tyre qëndron në faktin që luftojnë dhe vdesin për të sendërtuar dhe mbrojtur ideale heroike (famë, emër, atdhe, nder etj.). Por nga ana tjetër, një tisi tragjizmi i mbështjell ata të gjithë.
Argumentoni dhe ilustroni tragjizmin e heronjve në poemë?

-shënime-

Përkufizoni rolin e rrëfimit, përshkrimit dhe dialogut në poemë.

Kënga e parë

Në vargun më të famshëm të letërsisë botërore: Këndo hyjneshë mëninë e Akil Pelidit, tregoni cila është hyjnësia dhe cili është roli i saj?

Këndo hyjneshë mëninë e Akil Pelidit...

Pse fjala e parë është këndo?

Cili është konflikti i poemës, siç përcaktohet nga vargjet hyrëse të këngës së parë?

Vini re përdorimin e “mbiemrave” Akil Pelidi, Agamemnon Atridi.

*Këndo hyjneshë mëninë e Akil Pelidit
që shumë idhnime e kobe akejve u sollti,
dhe para kohe në skëterrë gremisi
me mijra shpirtna burrënorë fatosash;
kurmat e tyre gjellë ua hodhi qenve...*

Cili është ai që i ka vrarë dhe i ka dërguar në skëterrë këta fatosa, Akili?

-shënime-

*...mëninë e Akil Pelidit
që shumë idhnime e kobe akejve u solli,
dhe para kohe në skëterrë gremisi
me mijra shpirtna burrënorë fatosash.*

Cila është skëterra e përmendur në këto vargje? Pse përmendet me atë emër (përzgjedhje e përkthyesit)?

Vini re përcaktimet që u bëhen personazheve dhe tregoni ç'loj njerëzish janë ata:

*shpirtna burrërorë fatosash, mbretit të kreshnikëve, Akil
hyjnorit...*

Cila është pamja që përcjellin vargjet e mëposhtme?

*me mijra shpirtna burrënorë fatosash;
kurmat e tyre gjellë ua hodhi qenve
dhe shpesve grabitqarë...*